



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Premiera
Fatmir Matoshi
Drejtor
Kamenicë

Ankesa Nr. 2013/230 vs Radio Premiera
Ref: 1409/1036/KPM/a.s

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2013/230 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Radio Premiera (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 6 tetor 2009, ka vendosur që Palës Përgjegjëse t'i lëshoj licencë për transmetim si radio lokale në Komunën e Kamenicës.
2. KPM është vënë në dijeni, në bazë të listës së publikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që pronari i Palës Përgjegjëse ka filluar aktivitete duke u kandiduar për Kryetar të Komunës së Kamenicës, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe me nenin 9, paragrafi 1.2, të Rregullores së KPM-së për Dhënien e Licencës KPM- 2013/04.
3. KPM, me datën 19 shtator 2013, Palës Përgjegjëse përmes e-mailit i ka dërguar format e parapara për ndryshime në licencë, mirëpo Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i sjell format e plotësuar për ndryshimin e pronësisë në KPM. Me datën 11 tetor 2013, KPM ka ftuar Palën Përgjegjëse në zyrën e KPM-së, për të biseduar lidhur me këtë çështje.
4. KPM, bazuar në shkeljen e vazhdueshme të Ligjit të KPM-së dhe Rregullores KPM-2013/04 nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 25 tetor 2013, i ka dërguar Vërejtje me shkrim Palës Përgjegjëse për shkeljen e Ligjit të KPM-së Rregullores KPM 2013/04.
5. KPM, pas dërgimit të Vërejtjes me shkrim, me datën 27 tetor 2013 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes të cilës Pala Përgjegjëse pretendon se me datën 18 shtator 2013, ka dërguar një email në KPM, përmes së cilës ka hequr dorë nga pronësia.
6. Në bazë të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës neni 15, paragrafi 2, heqja dorë nga pronësia mund të prodhojë efekt ligjor vetëm atëherë kur aprovohet paraprakisht nga

KPM-ja. Pala përgjegjëse ka dërguar vetëm një email mirëpo ka dështuar të ndjek procedurën e paraparë me kushtet dhe termet e licencës duke dështuar të plotësojë format e nevojshme për heqjen dorë nga pronësia.

7. KPM konsideron se Pala Përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1 të Ligjit të KPM-së dhe me nenin 9, paragrafi 1.2 të Rregullores KPM-2013/04.
8. KPM, duke bazuar në shkeljet e vazhdueshme të nenit 22, paragrafi 3.1 të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2 të Rregullores KPM-2013/04 nga Pala Përgjegjëse, me datën 6 dhjetor 2013, ka sanksionuar me Vërejtje Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.
9. KPM, sërish me datën 30 maj 2014, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për bartjen e pronësisë, si dhe gjithashtu është njoftuar se vazhdimi i ushtrimit të pronësisë në Radio Premier, përderisa në të njëjtën kohë vazhdon të mbajë postin e Nënkrjetarit të Komunës së Kamenicës, do të rezultojë me masa sanksionuese nga KPM në pajtim me Ligjin e KPM-së.
10. Pala Përgjegjëse edhe përkundër sanksionimit me Vërejtje nga ana e Komisionit ka vazhduar të mbetet pronar i Radio Premierës, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2 të Rregullores KPM-2013/04.

Analiza Ligjore

10. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04 dhe të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së i cili përcakton se licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:

“partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike.”

11. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 3.1 të Ligjit të KPM-së, pasi që Pala Përgjegjëse është përfshirë në aktivitet politik dhe është zgjedhur Nënkrjetar i Komunës së Kamenicës.
12. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04, e cila gjithashtu parasheh se licenca nuk i lëshohet dhe nuk mund t'i jepet:

“partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike.”

13. Komisioni, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.

Vendimi

14. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së, dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.
15. Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së, dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04, pasi që vazhdon të mbetet pronar i subjektit transmetues Radio Premiera, edhe përkundër faktit se ushtron funksionin e Nënkryetarit të Komunës së Kamenicës e që është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së dhe me Rregullorën KPM-2013/04.
16. Komisioni, në bazë të nenit 30, paragrafi 1.6, vendos që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me ndërprerje të licencës së transmetimit për shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.

E drejta për Ankesë

17. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
datë